

## VENDIM

Nr .425, date 26.6.2003

PER DISA SHITESA NE VENDIMIN NR.116, DATE 18.3.1999 TE KESHILLIT TE MINISTRAVE "PER REZERVEN E SIGURISE SE NAFTAES, GAZIT DHE NENPRODUKTEVE TE TYRE"

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës dhe te nenit 9 te ligjit nr.8450, date 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

### V E N D O S I:

Ne vendimin nr.116, date 18.3.1999 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 1 bëhen shtesat si më poshtë vijojnë:

a) Në kategorinë II, pas fjalëve "Benzine automjesh" shtohen "Benzine mjesh të fluturimit ajror".

b) Në kategorinë III, pas fjalëve "Gazoil (Diezel)" shtohen "Lende djegëse për mjesh të fluturimit ajror, reaktive (Kerozene)".

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3.1 me këtë përmbajtje:

"3.1. Depozitat ku ruhet rezerva e sigurisë do të vlerësohen si magazina doganore, pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në Kodin Doganor dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij, sipas vlerësimit të autoritetit doganor."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano